

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6560
E mërkurë, 16 mars 2022
çmimi 0.40 €

Zelensky: Disa vende të NATO-s janë të hipnotizuara nga Rusia

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NË KUVENDIN E KOSOVËS ËSHTË DEBATUAR PËR RITJEN E ÇMIMEVE

OPOZITA, KRITIKA QEVERISË PËR RITJEN E ÇMIMEVE

FAQE 4-5



Partitë opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, kanë thirrur të martën seancë të jashtëzakonshme parlamentare për ritjen e çmimeve në vend. Gjatë kësaj seance liderët e opozitës kanë drejtuar akuza për kryeministrin Kurti për mosveprim për ta ndaluar ritjen enorme të çmimeve. Madje lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka qenë shumë i ashpër me akuza ndaj Kurtit, duke theksuar se për këtë krizë ai është dashur të shkojë në burg

Mbrojtja kundërshton prokurorinë: Përveç medieve, Gucati dhe Haradinaj nuk i kanë ofruar askujt qasje në dokumente

FAQE 3



KURTIT I SHTOHET KËRKESA NGA SHBA-JA PËR LEJIMIN E VOTIMIT TË SERBËVE NË KOSOVË

FAQE 4-5

AKTUALE



LIDERËT THEKSOJNË RËNDËSINË E AVANCIMIT TË AGJENDËS SHTETËRORE PËR FUQIZIMIN E GRUAS F. 7

PROKURORIA THEMELORE E MITROVICËS DHE GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS, PERFORMANCË TË DOBËT F. 6

22 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË F. 3

EKONOMI



INVESTIMET E FKPK-SË KANË RËNË RRETH 4 PËR QIND F. 8

ÇMIMET NË SHKURT U RRIËN MBI 7 PËR QIND, MBROJTJA E KONSUMATORIT E FORCON EKONOMINË F. 8

SPORT



DUKA, PAS RIZGJEDHJES KRYETAR I FSHF-SË: DUA T'I LË PAS TË GJITHA SHPIFJET DHE OFENDIMET F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zelensky: Disa vende të NATO-s janë të hipnotizuara nga Rusia

KIEV, 15 MARS - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka shprehur zhgënjimin e tij me aleancën ushtarake të NATO-s, pas refuzimit të kësaj të fundit për ta vendosur zonën e ndalimfluturimit mbi Ukrainë. Përmes një videolidhjeje, Zelensky ka folur të martën me kryeministrin britanik Boris Johnson dhe me përfaqësues të vendeve të tjera në Forcën e Përbashkët të Ekspeditës.

NATO-ja është "aleanca më e fortë në botë", por "disa nga anëtarët e kësaj aleance janë të hipnotizuar nga agresioni rus", ka theksuar Zelensky.

Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës qysh më 24 shkurt dhe Zelensky ka kërkuar disa herë nga NATO-ja që ta vendosë zonën e ndalimfluturimit mbi Ukrainë.

NATO-ja ka refuzuar, duke thënë se një veprim i tillë do të mund ta përshkallëzonte konfliktin në përmasat e një lufte të tretë botërore.

"Dëgjojmë shumë biseda për luftën e tretë botërore, se gjoja mund të fillojë nëse NATO-ja mbyll qiellin e Ukrainës për raketat dhe avionët rusë", tha Zelensky. Por kjo, shtoi ai, "i lejon ushtrisë ruse t'i bombardojë qytetet paqësore" dhe "të hedhë në erë blloqe banimi, spitale dhe shkolla". "Katër ndërtesa shumëkatëshe në Kiev, herët në mëngjes, janë bombarduar. Dhjetëra të



vdekur", tha ai.

Ushtria ruse ka shtuar sulmet në Kiev në përpjekje për ta marrë nën kontroll kryeqytetin e Ukrainës.

Kryetari i Kievit, Vitali Klitschko, tha se katër persona janë konfirmuar të vrarë pas sulmeve ajrore që goditën qytetin të hënën në mbremje.

BE-ja miraton edhe një raund sanksionesh kundër Rusisë

Bashkimi Evropian miratoi të martën një raund të ri

sanksionesh kundër Rusisë për shkak të pushtimit të Ukrainës. Sanksionet përfshijnë ndalesa të investimeve në sektorin energjetik rus, në eksportet e mallrave luksoze dhe në importet e produkteve të çelikut nga Rusia.

Sanksionet, që hyjnë në fuqi pas publikimit në gazetën zyrtare të BE-së, ngrijnë edhe asetet e shumë udhëheqësve të biznesit, që mbështetin shtetin rus, në mesin e tyre edhe pronari i klubit të futbollit Chelsea, Roman Abramovich.

Burime të BE-së i thanë agjencisë së lajmeve "Reuters" se

sanksionet do t'i godasin kompanitë kryesore të naftës në Rusi - Rosneft, Transneft dhe Gazprom Neft - edhe pse vendet anëtare të BE-së do të mund të vazhdojnë të blejnë naftë dhe gaz prej tyre. Sanksionet e fundit pasojnë tri raunde të tjera masash ndëshkuese, të cilat kanë përfshirë ngrirjen e aktiviteteve të Bankës Qendrore të Rusisë dhe përjashtimin nga sistemi bankar SWIFT i disa bankave ruse dhe bjelloruse. Në përgjigje të pushtimit të Ukrainës, ShBA-ja ka miratuar një varg sanksionesh të rënda kundër Rusisë, përfshirë

ndalimin e importit të naftës së saj.

Këshilltari ukrainas: Lufta duhet të përfundojë deri në maj

Një këshilltar i Qeverisë së Ukrainës ka thënë se pret që lufta në vendin e tij të përfundojë më së voni deri në fillim të majit, kur Rusisë "t'i mbarojnë burimet" për ta sulmuar fqinjën e saj. "Unë mendoj se jo më vonë se në maj, në fillim të majit, do të duhet të kemi një marrëveshje paqëje", ka theksuar Oleksiy Arestovich.

Në muajt në vazhdim, shtoi ai, mund të ndodhin dy skenarë: "Ose do të arrihet një marrëveshje paqëje shumë shpejt, brenda një ose dy javësh, me tërheqjen e trupave [ruse] dhe gjithçka... ose do të bëhen përpjekje për t'i mbledhur le të themi disa sirianë për një raund të dytë [luftimesh]. Kur t'i shkatërrojmë edhe ata, marrëveshja [do të arrihet] deri në mes të prillit ose në fund të prillit", ka deklaruar Arestovich. Pentagoni ka pohuar më herët se rusët po përpiqen të rekrutojnë sirianë për të luftuar në Ukrainë edhe pse kjo nuk është verifikuar.

Arestovich nuk është i përfshirë personalisht në bisedimet për paqe midis Ukrainës dhe Rusisë.

Borrelli në Tiranë: Të rijetësohet procesi i integritetit të Ballkanit

TIRANË, 15 MARS - Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ka thënë se ka ardhur koha të rijetësohet procesi i zgjerimit dhe Ballkani Perëndimor të bëhet pjesë e paktyeshme e Bashkimit Evropian. "Të qenët të bashkuar është më e rëndësishme se kurrë. Ka ardhur koha që të rigjallërohet procesi i zgjerimit. E di që këtë ndoshta e keni dëgjuar edhe herë të tjera në të shkuarën. Ju vetë (Ramës) keni thënë se na duhen vepra e jo fjalë", ka deklaruar Borrell në një konferencë për medie me kryeministrin shqiptar Edi Rama, gjatë vizitës së tij në Shqipëri.

Ai vlerësoi rreshtimin e Shqipërisë me vendet e tjera të BE-së, duke thënë se "Shqipëria ka rikonfirmuar angazhimin dhe përkushtimin e saj për rendin dhe sigurinë

ndërkombëtare". "Shqipëria e ka treguar qartë se është një nga partnerët më të besueshëm të Bashkimit Evropian dhe në botë. Politikat e Shqipërisë janë 100 për qind në përputhje me politikën e përbashkët të BE-së për çështjet e jashtme dhe të sigurisë. Edhe para luftës, edhe në këto kohë sprove Shqipëria ka rikonfirmuar angazhimin dhe përkushtimin e saj për rendin dhe sigurinë ndërkombëtare", u shpreh Borrell.

Kryeministri Rama, në anën tjetër, përsëriti nevojën për hapjen formale të bisedimeve për anëtarësim, porse tregoi skepticizëm për këtë proces. "Sa më shpejt ta bëjnë, aq më shumë është në nderin e tyre, sepse po kalon shumë kohë duke premtuar e duke mos i mbajtur premtimet, por ne tashmë e kuptojmë që kjo nuk është çështje vullneti të përbashkët të Këshillit



Evropian, por është çështje e një bllokimi mes dy vendeve të tjera [Maqedonisë së Veriut dhe

Bullgarisë]", u shpreh Rama. Ai, ndër të tjera, i bëri thirrje Bashkimit Evropian që Ballkani

Perëndimor mos të mbetet jashtë planit për përballim të krizës ekonomike.

NË KUVENDIN E KOSOVËS ËSHTË DEBATUAR PËR RRIJTJEN E ÇMIMEVE

Opozita, kritika qeverisë për rritjen e çmimeve

Partitë opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, kanë thirrur të martën seancë të jashtëzakonshme parlamentare për rritjen e çmimeve në vend. Gjatë kësaj seance liderët e opozitës kanë drejtuar akuza për kryeministrin Kurti për mosveprim për ta ndaluar rritjen enorme të çmimeve. Madje lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka qenë shumë i ashpër me akuza ndaj Kurtit, duke theksuar se për këtë krizë ai është dashur të shkojë në burg

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 MARS - Qeveria e Kosovës po reagon me vonesë dhe pa takt ndaj krizave me të cilat së fundi po përballet Kosova, qoftë me atë në energjetikë, edhe tani me atë të rritjes së çmimeve, ka thënë të martën deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Hykmete Bajrami, teksa ka paraqitur temën për të cilën është thirrur seanca e jashtëzakonshme parlamentare. "Rritja e çmimeve është bërë pandemi e dytë. Nuk ka produkt të cilit nuk i ka lëvizur çmimi. Inflacioni mbetet një nga kërcënimet kryesore të rimëkëmbjes së shpejtë dhe të rënies së fuqisë blerëse për qytetarët tanë", ka thënë deputetja Bajrami.

Partitë opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e kanë thirrur seancën e jashtëzakonshme parlamentare për rritjen e çmimeve. Deputetja Bajrami ka thënë se Qeveria e Kosovës ka shkelur Kushtetutën, duke ndërhyrë në tregun e lirë, me qëllim që ta zbusë ndikimin e rritjes së çmimeve. "Duhet t'i menaxhoni krizat e tilla. Me ndërhyrjet tuaja po shkaktoni dëme - ekonomisë dhe qytetarëve, duke maksimalizuar dëmet", ka thënë Bajrami. Ajo ka përmendur rritjen e çmimeve të karburanteve dhe të vajit. Te rasti i fundit ajo ka pranuar se disa kompani e kanë keqpërdorur situatën, por ka thënë se ekzekutivi nuk duhet ta godasë të gjithë sektorin privat. "Ngritja e çmimit të karburanteve ndikoi që brenda disa ditësh të kemi ngritje eksponenciale për shumë artikuj që janë esenciale për jetën e qytetarëve. Sa i përket rritjes së çmimeve të karburanteve, disa vende hoqën apo zvogëluan akcizën, bashkë me të edhe Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, për t'u dalë sadopak në ndihmë qytetarëve. Qeveria jonë nuk bëri asgjë. Qeveria e mori një

vendim për marzhën e kufizimit të përfitimit për naftëtarët 4 dhe 6 për qind", ka deklaruar Bajrami.

Ajo e ka kritikuar edhe reagimin e qeverisë për krizën energjetike dhe ka thënë se këtë muaj do të ndihet pesha e rritjes së tarifave të energjisë elektrike dhe e ka ftuar që t'i marrë praktikën e shteteve në rajon që qytetarët ta tejkalojnë më lehtë krizën me energjinë dhe rritjen e çmimeve.

Ndërkaq shefja e grupit parlamentar e partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka kritikuar opozitën se po tenton që ta paraqesë ekzekutivin si joaktiv ndaj ngjarjeve që po ndodhin në Kosovë dhe botë. Ajo ka thënë se kriza që ka goditur botën për shkak luftës në Ukrainë, pashmangshëm që e ka prekur Kosovën. "Ky debat i ditës së sotme, përveç që synon të keqinformojë për mosiniciativat e ashtuquajtura të qeverisë, për qëllim ka thellimin e panikut dhe ndjenjës së paqartësisë, në kohën kur e gjithë bota, natyrisht edhe Kosova, ballafaqohen me pamjet e rënda të luftës së egër në Ukrainë", ka thënë Kusari-Lila, duke shtuar se është e padrejtë që të akuzohet kjo qeveri për mosaktivitet apo mosreagim.

Kusari-Lila ka thënë se disa kompani përfituan nga ngjarjet në Ukrainë, ku Rusia që prej 24 shkurtit ka nisur pushtimin e këtij shteti, për të nxjerrë fitime komerciale. "Fatkeqësisht ishte e njëjta ndjenjë e cila u provua të ushqej dhe të rritej nga një kompani apo disa kompani kosovare, të cilat, siç duket, përfitimet nga kriza, qoftë ajo e pandemisë, apo tani ajo e luftës në Ukrainë, e kanë specialitet, me qëllim purokomercial, qoftë edhe nëse ky fitim nënkupton krijimin e panikut dhe stresit nga pamjet që shohim. Ato kompani i bënë ato lëvizje për përfitime komerciale, ju sot natyrisht se e bëni këtë debat për përfitim politik", ka thënë shefja e deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka thënë se Agjencia e Statistikave ka nxjerrë vlerësimin e saj të fundit, sipas të cilit, për produktet e konsumit për bukë dhe drithëra ka një rritje prej 15.7-përqindësh. "Për mish, që është, po ashtu, produkt bazë, 8.6 për qind rritje. Për qumësht, djathë dhe vezë, 11.1 për qind rritje. Vajra dhe yndyra ushqimore, 32.1 për qind rritje të çmimit. Ndërsa për karburante, deri në 35 për qind. Kjo e bën shumë të qartë situatën në të cilën jemi përfshirë", ka thënë ai.

Krasniqi ka thënë se e kupton që kryeministri dhe qeveria nuk kanë faj ekskluziv për rritjen e çmimeve, por faji i tyre është që kanë marrë detyra që s'mund t'i kryejnë siç duhet. "Sepse për një periudhë tremujore po ju përsëritet historia e njëjtë. Ngjashëm si edhe për energjinë elektrike, për të cilën nuk patët kurrfarë plani deri kur goditën reduktimet, ashtu edhe për këtë krizë nuk keni kurrfarë plani. Ju, normalisht, mund të thoni që lufta në Ukrainë i ka shkakuar këto. Por, pyetja nuk është çka e ka shkakuar këtë shpërthim të çmimeve. Pyetja është çka keni bërë ju ndërkohë për ta ballafaquar këtë krizë?", ka thënë Krasniqi. Sipas Krasniqit, pikërisht ky mosveprim i qeverisë po ndikon që qytetarët ta humbin besimin në qeverinë e vendit. "Ju keni konstatuar se kjo është kostoja e lirisë dhe demokracisë. Nëse është ashtu, jemi gati ta paguajmë atë kosto veç mos të jetë si bakshish edhe kostoja e paafetësisë suaj se pastaj po bëhet kosto tepër e rëndë të përballohet, edhe si shtet, edhe si vend, edhe si qytetarë. Prej kur u shtrenjtua çmimi i energjisë elektrike, qytetarët janë të brengosur si kanë për të paguar atë rritje me këtë nivel pagash. Asnjë hap s'është

ndërmarrë për rritjen e pagave. As në sektorin publik as në atë privat. As paga minimale nuk është përcaktuar ende, që ka qenë premtim madhor i juaji. Dhe sinqerisht, nëse ai propozim që ka dalë nga qeveria është i vërtetë, së paku bile mos i mashtroni njerëzit duke u thënë që po e rritni pagën minimale, se në këto kushte ajo veç rritje nuk është", ka thënë Krasniqi.

Ndërkaq, kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se Kosova është duke u përballur me rritjen më të madhe të inflacionit brenda vitit. Ai ka kërkuar që të ketë lehtësime tatimore, në mënyrë që të tejkalojë kriza me rritjen e çmimeve, e cila ka thënë se është "e papërbalueshme për qytetarët". "Ne kërkojmë të ketë reduktim të akcizës, të ketë reduktim të TVSh-së në lëndë të parë dhe heqje të TVSh-së në të gjitha produktet bazike të shportës së konsumatorit. Këto janë masa imediate. Mund të përdoren për një periudhë afatshkurtër derisa të kapërcejë kriza, sidomos në lëndë të parë, në mënyrë që të mos destabilizohet buxheti i vendit. Të tjerat janë çështje të përbalueshmërisë së qytetarëve tanë", ka deklaruar Abdixhiku, duke shtuar se rritja e çmimeve të energjisë elektrike, rritja e çmimeve të derivateve, rritja e çmimeve të produkteve bazike janë bërë të papërbalueshme për qytetarët në një periudhë kaq të shpejtë dhe kaq të ngjeshur kohore.

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se kryeministri Albin Kurti është dashur të hynte në burg për shkak se nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ta tejkalluar krizën e rritjes së çmimeve. Haradinaj është shprehur para deputetëve se Albin

Kurti me stafin e qeverisë janë befusuar me çmimet në rritje, ndaj për t'u mbuluar nga dështimet kanë nisur aksionin për t'i "çuar do në burg". "Merreni me mend, ju jeni befusuar se po rriten çmimet në vendin tuaj. E keni gjetur litrin e vajit 3.49 në shtetin ku udhëhiqni. E pastaj për të mbuluar atë marre, je duke i ndjekur do për t'i çuar në burg. Besomëni, para se me i ndjek ata, është dashur me hy në burg kryeministri, sepse asnjë veprim se ke marrë për ta tejkalluar këtë krizë", ka thënë Haradinaj.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka paraqitur para deputetëve masat e ndërmarrura nga qeveria që ai udhëheq. Ai ka thënë se për të pasur një treg konkurrues, ekzekutivi ka rritur inspektimet në kompanitë private. "Deri më sot janë ndërmarrë 251 inspektime dhe janë shqiptuar 30 gjopa nga ana e inspektorëve të tregut qendror dhe ata komunalë. Pra, qeveria qendrore dhe lokale, bashkë në mbrojtje të qytetarit dhe mirëqenies. Ajo që po shihet qartë është se qytetarët nuk janë kundër taksave të shtetit, por kundër vjedhjes së zhepit. Qytetarët duan rend dhe zbatim të ligjit, rritje të inspektimeve dhe dënim të mashtruesve", ka thënë Kurti.

Së fundmi, çmimet e prodhimeve ushqimore, të disa shërbimeve dhe çmimet e naftës kanë shënuar rritje. Një litër naftë para disa ditësh shitej për rreth 1.70 euro, ndërkaq aktualisht ky çmim është rreth 1.50 euro. Çmimi i vajit më 9 mars ishte ngritur në 3.49 euro për litër nga rreth 2 euro sa ishte më 8 mars. Për shkak të dyshimeve se operatorët ekonomikë po bëjnë veprime për mashtrimin e konsumatorëve, Inspektorati i Tregut në Kosovë ka thënë se ka mbyllur përkohësisht depot e operatorëve.

22 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 15 MARS (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 907 testeve, 22 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me

virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të martën janë shënuar edhe 62 qytetarë, ndërsa numri i

përgjithshëm i të shëruarve është 223 158. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 633.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 356 doza të vaksinës kundër

Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 818 098 doza të vaksinës. Deri më sot 818 561 qytetarë janë

vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 98 717 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



Kurtit i shtohet kërkesa nga ShBA-ja për lejimin e votimit të serbëve në Kosovë

Më 3 prill Serbia do t'i mbajë zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare. Kryeministrit Albin Kurti i është shtuar kërkesa nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA-ja) për lejimin e votimit të qytetarëve serbë në Kosovë. Kurti të hënën ka zhvilluar një bisedë telefonike me këshilltarin special në Departamentin Amerikan të Shtetit, Derek Chollet, i cili ka theksuar rëndësinë e votimit të serbëve në Kosovë, në mënyrë që të marrin pjesë në zgjedhjet e Serbisë. Vetë kryeministri Kurti ka thënë se po komunikojnë me ndërkombëtarët se çfarë zgjidhje mund të gjejnë për votimin e qytetarëve serbë në Kosovë.

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 15 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, të hënën ka zhvilluar një bisedë telefonike me këshilltarin special në Departamentin Amerikan të Shtetit, Derek Chollet. Siç njofton Chollet në rrjetin social "Twitter", me Kurtin ka folur për agresionin rus në Ukrainë dhe për zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të Serbisë më 3 prill. Ai ka theksuar rëndësinë e votimit të serbëve në Kosovë, në mënyrë që të marrin pjesë në zgjedhjet e Serbisë. "Me kryeministrin Albin Kurti. E falënderoj atë për mbështetjen e tij të fortë në Ukrainë dhe theksova rëndësinë e sigurimit të votuesve me të drejtë vote në Kosovë që të mund të marrin pjesë në zgjedhjet e përgjithshme të Serbisë që do të mbahen më 3 prill", ka shkruar këshilltari i DASH-it.

Kosova do ta shqyrtojë mundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale serbe, nëse Beogradi zyrtar i dërgon kërkesë Qeverisë së Kosovës, ka thënë të hënën shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila. "Përgjigja e institucioneve të Kosovës, tashmë e konfirmuar edhe në nivel të legjislativit, është që vetëm në një pranim të kërkesës zyrtare nga shteti i Serbisë drejtuar shtetit të Kosovës me kërkesë bazuar në ligjet e aplikueshme të Kosovës dhe në praktikën evropiane, do të shqyrtohej ajo kërkesë dhe do të merrej vendimi për apo kundër mbajtjes së zgjedhjeve", ka deklaruar Kusari-Lila. Ajo ka shtuar se deri më tani nuk ka ndonjë kërkesë zyrtare nga Serbia drejtuar institucioneve të Kosovës. Sipas Kusari-Lilës, Beogradi u është drejtuar

institucioneve ndërkombëtare për mundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve, por ajo tha se "në Kosovë autoriteti sovran është Qeveria e Kosovës dhe institucionet e Kosovës". Më 16 janar nuk u lejua hapja e vendotimeve në Kosovë për votimin e serbëve në referendumin e Serbisë. Me kërkesën e kryeministrit Kurti, Kuvendi i Kosovës, në një seancë të jashtëzakonshme, më 15 janar të këtij viti miratoi rezolutën që kundërshtonte mbajtjen e votimeve në Kosovë për referendumin e shtetit të Serbisë për ndryshime kushtetuese. Lidhur me atë se Qeveria e Kosovës ka marrë ndonjë vendim për mbajtjen ose jo të zgjedhjeve serbe në Kosovë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se bashkërisht me ambasadorët e Quintit dhe të BE-së që veprojnë në vend, po përpiqen të gjejnë

Zgjedhjet serbe në Kosovë, "praktikë jokushtetuese"

Profesori i së Drejtës Kushtetuese në Universitetin e Prishtinës, Arsim Bajrami, i cili ka qenë në grupin e ekspertëve që kanë përpiluar Kushtetutën e Kosovës, ka thënë se Kosova, për një periudhë kohore, ka toleruar mbajtjen e zgjedhjeve serbe në territorin e saj, duke u bazuar në frymën e Dokumentit të Ahtisaarit - në bazë të të cilit dokument u shpall pavarësia në vitin 2008, por edhe në bazë të një tolerance, përtej obligimeve të saj kushtetuese. Kjo praktikë, siç thotë ai, ka qenë një qasje konstruktive e Kosovës për t'i dhënë hapësirë dialogut dhe normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë. Por, siç thotë ai, procesi i dialogut nuk ka shënuar përparim, ndërsa Serbia e ka keqpërdorur,

siç e quan ai, "zemërgjerësinë e institucioneve të Kosovës", duke e provokuar sovranitetin dhe integritetin e Kosovës. "Edhe kjo praktikë [hapja e vendotimeve në Kosovë për zgjedhjet e Serbisë] është jokushtetuese. Unë mendoj që në të ardhmen duhet të sqarohen këto çështje, në kuadër të dialogut [Kosovë-Serbi], sidomos çështja e mbajtjes së mëtejshme të zgjedhjeve serbe". "Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës kanë autoritetin e plotë për të vendosur për mbajtjen apo mosmbajtjen [e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë] dhe asnjë dispozitë ndërkombëtare nuk shkelet me këtë në qoftë se veprohet njëjtë sikurse edhe te rasti i referendimit", ka deklaruar Bajrami.

zgjidhje. "Ne kemi shprehur qëndrimin tonë dhe konsiderojmë që në njërin anë nuk duhet që t'u pamundësojmë serbëve në Kosovë, që përveçse kanë nënshtrësinë e Kosovës dhe atë të

Serbisë, ta kenë të drejtën e votës, në anën tjetër kushtetutshmëria, ligji në Kosovë, rezoluta e fundit e 15 janarit, neve na obligojnë bazën e çfarëdo zgjidhje që do të marrim në të ardhmen. Jemi në kontakt

Mbrojtja kundërshton prokurorinë: Përveç medieve, Gucati dhe Haradinaj nuk i kanë ofruar qasje askujt në dokumente

HAGË, 15 MARS - Avokati i Hysni Gucati ka deklaruar se drejtuesit e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së nuk u kishin ofruar qasje në dokumente askujt përveç medieve.

Jonathan Elystan Rees, derisa ka paraqitur deklaratën përmblylëse të mbrojtjes, ka thënë se Gucati e Haradinaj, ndër të tjera, u kanë kërkuar gazetarëve që të mos i publikojnë emrat e dëshmitarëve të mundshëm që ishin pjesë e dosjeve që kishin arritur në OVLUÇK nga persona ende të panjohur.

Rees ka thënë para trupit gjykues se krerët e OVLUÇK-së dhe avokati i tyre u kanë thënë medieve që mund ta publikojnë komunikimin në mes të Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe zyrtarëve serbë, por jo edhe emrat e personave të cilët mund të ishin dëshmitarë. "Në paragrafin 66 të dosjes së tyre përfundimtare, ZPS-ja thotë se njerëz të tjerë, përveç anëtarë të shtypit, kanë pasur mundësi të hyjnë në këtë ndërtesë dhe mund t'i kenë parë këto

dokumente, kjo nuk ka asnjë provë që të provojë që njerëz të tjerë, përveç anëtarëve të shtypit, të mund të kenë pasur qasje në këto dokumente", ka thënë avokati i Gucati.

Ai ka theksuar se Hysni Gucati i ka ftuar gazetarët që t'i lexojnë dokumentet, por nuk u ka thënë që t'i botojnë emrat të cilët përmendeshin aty. "Zotëri Gucati dhe zotëri Haradinaj i kanë kërkuar gjithnjë shtypit që t'i mbronë emrat e dëshmitarëve që shfaqeshin në këto dokumente të cilat i janë lejuar shtypit t'i shfrytëzojë... Mund të shohim këtu që zotëri Gucati, siç e ka bërë që nga fillimi, e fton shtypin që të lexojë dokumentet, ai nuk thotë që të botohen emrat", ka thënë Rees. Mbrojtja e Hysni Gucati është duke e paraqitur deklaratën përmblylëse pasi gjatë ditës së djeshme ZPS e ka përfunduar deklaratën e saj.

Deklaratat përmblylëse po dëgjohen pasi kanë përfunduar paraqitjet e provave dhe dëshmitarëve nga të dyja palët.



Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj janë arrestuar më 25 shtator 2020 prej kur edhe po qëndrojnë në paraburgim në Hagë. Rrjedhja e disa dokumenteve nga Specialja, të cilat nga një person ende i

panjohur janë dërguar në zyrat e OVLUÇK-së, dhe bërja publike e kësaj ngjarje nga krerët e organizatës, është arsyeja pse po gjykohen Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj.

Mbi ta rëndojnë akuzat për vepra

penale kundër administrimit të drejtësisë, konkretisht për pengim të personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, për frikësim të dëshmitarëve, për hakmarrje dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurës.

Kërkohet një muaj paraburgim për policët dhe doganierët

PRISHTINË, 15 MARS - Prokuroria Speciale e Kosovës ka kërkuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës që ta shqiptojë masën e paraburgimit prej një muaji për 50 zyrtarët policorë dhe doganorë që dyshohen për "marrje ryshfeti" dhe "keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar".

Seanca për masën e paraburgimit ka nisur të martën në orën 10:00 në Gjykatën Themelore të Prishtinës, një ditë pas aksionit të Inspektoratit të Policisë së Kosovës, pas arrestimit të të pandehurve. Sipas kërkesës për vendosjen e



masës së paraburgimit, thuhet se të pandehurit, në cilësinë e zyrtarëve policorë dhe doganorë, prej muajit shkurt deri në muajin

dhjetor të vitit 2021, në pikën kufitare Qafë-Prush, duke vepruar në mënyrë të organizuar apo edhe individualisht, me

qëllim të përfuturit material për vete dhe të tjerët, kanë keqpërdorur detyrën zyrtare duke pranuar ryshfet nga qytetarët e Kosovës dhe Shqipërisë, duke u mundësuar të hyjnë në territorin e Kosovës përmes shmangies së pagesave të tarifave doganore.

Më 14 mars u arrestuan 48 policë dhe dy zyrtarë doganorë.

Kryeshafi i Inspektoratit të Policisë së Kosovës, Kushtrim Hodaj, tha se të arrestuarit dyshohet se kanë marrë pjesë në mbi 400 aktivitete të marrjes së ryshfetit në pikat kufitare të Qafë-Prushit dhe Qafë-Morinës, që

lidhin Kosovën dhe Shqipërinë. Inspektorati veçse ka ndërmarrë masat për suspendimin e policëve të arrestuar.

Ndërkaq, Prokuroria Speciale ka bërë me dije se hetimi për këtë rast ka nisur një vit më parë ndaj 68 personave dhe disa persona janë ende në arrati, përfshirë edhe shtetas të Shqipërisë.

Në mesin e të arrestuarve, sipas IPK-së, janë dy togerë policorë, pesë rreshterë dhe dy zyrtarë doganorë. Ky operacion i IPK-së, sipas autoriteteve, është përkrahur edhe nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Dogana e Kosovës dhe Policia e Kosovës.

me ambasadat e Quintit dhe të BE-së këtu në Kosovë në mënyrë që të shohim se çfarë zgjidhje mund të gjejmë që edhe të drejtat të mos shkelen, por kurrsesi të mos cenohen shtetësia, kushtetutshmëria, sundimi i ligjit dhe rezoluta", ka deklaruar Kurti. OSBE-ja ka bërë me dije se janë të gatshëm t'i grumbullojnë votat edhe për zgjedhjet e reja, por me pëlqimin e të gjitha institucioneve përkatëse.

Ndërkaq, partitë opozitare në Kosovë kanë thanë se presin koordinim më të mirë në mes të pushtetit dhe opozitës për këtë temë.

Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës, Blerta Deliu-Kodra, ka thënë se beson se "do të kemi një koordinim më të qartë sepse na

presin edhe pak ditë deri në mbajtje të zgjedhjeve".

Dy partitë e tjera opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, kanë thënë se Qeveria e Kosovës duhet t'i respektojë obligimet që ka marrë nga një rezolutë e Kuvendit të Kosovës, që u miratua kundër mbajtjes së referendumit të Serbisë për ndryshimet kushtetuese. Ky referendum në Serbi u mbajt më 16 janar. "Ne presim që qeveria të sillt karshi obligimeve që ka marrë nga Kuvendi", ka theksuar deputeti i LDK-së, Driton Selmanaj.

Ndërkaq deputetja e AAK-së, Time Kadrijaj, ka thënë se "duhet të respektohen ligjet e Kosovës, duhet të respektohet Kushtetuta e

Kosovës dhe konform tyre duhet të veprojnë edhe Kosova".

Në vizitën në Kosovë gjatë javës së kaluar, ministrja e Jashtme gjermane, Analea Berbock, ka theksuar se Kosova dhe Serbia duhet të gjejnë mënyra që të mbahen zgjedhjet. Zgjedhjet e fundit parlamentare, që Serbia i organizoi edhe në komunitetin serb në Kosovë, u mbajtën më 21 qershor të vitit 2020. Ato zgjedhje u mbajtën sipas praktikës së mëhershme, ku misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë kishte grumbulluar votat. Kjo praktikë është krijuar më 2017 dhe autoritetet e Kosovës e kishin lejuar këtë gjë.

OSBE-ja grumbullonte votat pas mbylljes së qendrave të votimit,

më pas ato numëroheshin në Rashkë dhe Vranjë, dy qytete kufitare të Serbisë.

Më 14 janar, pas takimit që krerët e institucioneve më të larta të Kosovës, presidentja Vjosa Osmani, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, dhe kryeministri Albin Kurti kanë mbajtur me ambasadorët e Quintit, ata kanë thënë se "praktikat e deritanishme, të aplikuara që nga viti 2012, kanë qenë kundërkushtetuese" dhe se ato "nuk i obligojnë institucionet e tanishme të Republikës së Kosovës", të dala nga "vullneti i qartë i qytetarëve", i shprehur në zgjedhjet e 14 shkurtit, 2021. "...aq më tepër kur këto praktika kanë rezultuar vetëm me fuqizimin e strukturave ilegale të Serbisë në Kosovë", kanë thënë në deklaratën

e përbashkët tre udhëheqësit e institucioneve të larta të Kosovës.

Vetëm pak muaj pasi Kosova shpalli pavarësinë më 17 shkurt 2008, Serbia organizoi zgjedhjet parlamentare në mjediset me shumicë serbe në Kosovë. Në këto zgjedhje, të cilat u mbajtën më 11 maj 2008, sipas të dhënave të Komisionit Republikan të Zgjedhjeve të Serbisë, të drejtën e votës në vendvotimet në Kosovë e shfrytëzuan rreth 90 mijë qytetarë të Serbisë.

Zgjedhjet parlamentare të Serbisë në territorin e Kosovës u mbajtën më 2012, më 2014 dhe më 2016. Zgjedhjet e fundit parlamentare, të cilat Serbia i organizoi në mjediset e banuara me shumicë serbe në Kosovë, u mbajtën më 21 qershor 2020.

Prokuroria Themelore e Mitrovicës dhe Gjykata Themelore e Prishtinës, performancë të dobët

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 15 MARS - Lëvizja Fol ka publikuar raportin "Performanca e sistemit prokurorial dhe gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021 (analizë statistikore)", i cili e adreson çështjen e performancës dhe efikasitetit të shkallës së parë të sistemit gjyqësor dhe të atij prokurorial në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit gjatë periudhës janar-dhjetor 2021, si dhe shtjellon nivelin e ngarkesës së punës së këtyre institucioneve për zgjidhjen e këtyre lëndëve. Raporti është bazuar në të dhënat statistikore zyrtare të pranuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës për vitin 2021, ndërsa për matjen e performancës së këtyre institucioneve mbi bazën e këtyre statistikave zyrtare, Fol ka përdorur metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ). Raporti nuk përfshinë cilësinë e lëndëve, apo cilësinë e punës së prokurorive dhe gjykatave, por vetëm matjen statistikore të tyre. Albana Hasani, hulumtuuese në Lëvizjen Fol, ka prezantuar gjetjet kryesore të këtij raporti. Ajo ka thënë se, bazuar në të dhënat e përgjithshme

statistikore të pranuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, Prokuroria që ka arritur rezultatet më të mira në trajtimin e rasteve të korrupsionit gjatë kësaj periudhe është Prokuroria Themelore e Prizrenit, e cila gjatë kësaj periudhe ka arritur normën më të lartë të zgjidhjes së lëndëve (120 për qind), normën më të lartë të qarkullimit të lëndëve (4.29 për qind) si dhe kohën më të shkurtër të nevojshme për zgjidhjen e lëndëve që këtë vit kishin ngelur të pazgjidhura. "Me fjalë të tjera, nga 90 lëndë të korrupsionit sa ka pasur në punë kjo prokurori, ka arritur të zgjidhë 73 prej tyre, apo 81 për qind", ka thënë Hasani.

Ndërkaq prokuroria me rezultatet më të dobëta për trajtimin e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021 (njëjtë sikurse në vitin 2020) ishte Prokuroria Themelore e Mitrovicës.

Hasani ka treguar se kjo prokurori gjatë kësaj periudhe ka arritur normën më të ulët të qarkullimit të lëndëve (0.26), normën më të ulët të zgjidhjes së lëndëve (44 për qind) si dhe indeksin më të lartë të lëndëve të grumbulluara (2.96). "Me fjalë të tjera, nga 133 lëndë sa kjo prokurori ka pasur në punë gjatë këtij viti, ka arritur të zgjidhë vetëm 28 prej tyre, apo vetëm 13 për qind të gjitha



lëndëve që i ka pasur në punë", është shprehur ajo.

Ndërsa rezultatet më të dobëta në trajtimin e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021 i ka arritur Gjykata Themelore e Prishtinës, e cila nga 197 lëndë sa ka pasur në punë në vitin 2021, ka arritur të zgjidhë vetëm 34 prej tyre, apo vetëm 17 për qind. "Kjo gjykatë gjatë kësaj periudhe e ka arritur normën më të ulët të qarkullimit të lëndëve (0.20), indeksin më të lartë të grumbullimit të lëndëve (4.61), si dhe kohën më të gjatë për zgjidhjen e lëndëve që këtë vit

kishin ngelur të pazgjidhura", ka thënë Hasani.

Ndërsa sa iu përket gjetjeve në lidhje me sistemin gjyqësor, Hasani ka theksuar: "Shtatë gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2021 i kanë pasur në punë gjithsej 383 lëndë të korrupsionit (281 prej të cilave kanë qenë të trashëguara nga viti paraprak dhe 102 lëndë të reja të krijuara gjatë vitit), ndërsa kanë arritur të zgjidhin vetëm 108 lëndë, apo 28 për qind të të gjitha lëndëve që i kanë pasur në punë". Sipas saj, 73 për qind e lëndëve të

korupsionit që kanë qenë në punë gjatë vitit 2021, përkatësisht 281 lëndë, ishin trashëguar nga vitet paraprake. Sipas këtij raporti, gjykatat themelore gjatë vitit 2021 kanë nxjerrë 59 aktgjykime fajësuese, 26 aktgjykime liruese, 4 aktgjykime refuzuese, si dhe 19 lëndë janë zgjidhur në mënyra të tjera. Nga aktgjykimet fajësuese, për pjesën më të madhe të tyre, përkatësisht për 31 lëndë, janë shqiptuar dënime me gjobë, ndërsa për 22 lëndë janë shqiptuar dënime me burg dhe për 6 lëndë dënime me kusht.

Sfidat e bizneseve për përmbushje të kontratave publike

PRISHTINË, 15 MARS (ER) - Pas kërkesave të pranuar nga bizneset anëtare në lidhje me dëmet dhe humbjet e mëdha financiare që po u shkaktohen këtyre të fundit nga ndryshimet enorme të çmimeve, pët përmbushje të kontratave publike të nënshkruar më herët, Oda e Afarizmit e Kosovës ka mbajtur konferencë për medie me temë "Sfidat e bizneseve në përmbushje të kontratave publike".

Qëllimi i kësaj konference ishte njoftimi i institucioneve me kërkesat nga komuniteti i biznesit, pas një takimi paraprak të mbajtur me bizneset anëtare, të cilat shfaqën shqetësimet për humbjet e mëdha që po u shkaktohen nga gjendja aktuale.

Hasan Gigollaj, anëtar i bordit të Odës së Afarizmit të Kosovës, ka thënë se bizneseve në vazhdimësi po u shkaktohen vështirësi financiare për shkak të

kontratave të nënshkruara me autoritetet publike, sidomos tani pas rritjes së vazhdueshme të çmimeve. "Këto kontrata po hasin vështirësi të përmbushjes si rrjedhojë e rrethanave të paparashikueshme si dhe inflacionit që po ndodh", ka thënë Gigollaj.

OAK-u përmes kësaj konference ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës dhe organet kompetente që të ndërmerren hapa konkretë për të ofruar zgjidhje, një ndër të cilat është edhe rinegociimi i çmimeve dhe zbatimi i kontratave sipas praktikave ndërkombëtare. Ndër të tjera, në konferencë u theksua se gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 komuniteti i biznesit ka tentuar që të tregojë mirëkuptim, mirëpo gjendja e krijuar ndërmjet Ukrainës dhe Rusisë ka bërë që, përveç ndryshimeve në çmime, të haset edhe vështirësi në furnizime.

Gigollaj ka thënë se operatorët



ekonomikë kanë nënshkruar kontrata me institucionet publike në kohën kur kishim një stabilitet të çmimeve ashtu që ndryshimi i këtyre rrethanave po bën që

bizneseve t'u shkaktohen humbje. Ai ka theksuar se implementimi i kontratave me kushtet e kontraktuara më herët do t'i vendosë bizneset para opsioneve të vështira.

"Çka do të dërgonte në falimentimin e bizneseve dhe shuarjen e vendeve të punës, në rast të mosndërmarrjes së hapave konkretë", ka thënë Gigollaj.

MBAHET KONFERENCA DYDITORE JAVA E GRUAS 2022 "NË MBROJTJE TË DEMOKRACISË: GJITHËPËRFSHIRJA KA RËNDËSI"

Liderët theksojnë rëndësinë e avancimit të agjendës shtetërore për fuqizimin e gruas

Në kuadër të konferencës Java e Gruas 2022 liderët politikë theksuan rëndësinë e avancimit të agjendës shtetërore për fuqizimin e gruas dhe për pjesëmarrjen e plotë të grave në jetën publike. Ata diskutuan rëndësinë për një proces formal në parti politike për përzgjedhjen dhe emërimin e kandidateve në listat e tyre, për të dhënë qasje në financa dhe rrjetëzime dhe për t'i mbrojtur gratë nga dhuna në politikë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 15 MARS - Në organizim të Institutit Kombëtar Demokratik (NDI), në Prishtinë, është mbajtur konferenca dyditore Java e Gruas 2022 "Në mbrojtje të demokracisë: gjithëpërfshirja ka rëndësi".

Në kuadër të kësaj konference liderët politikë theksuan rëndësinë e avancimit të agjendës shtetërore për fuqizimin e gruas dhe për pjesëmarrjen e plotë të grave në jetën publike. Ata diskutuan rëndësinë për një proces formal në parti politike për përzgjedhjen dhe emërimin e kandidateve në listat e tyre, për të dhënë qasje në financa dhe rrjetëzime dhe për t'i mbrojtur gratë nga dhuna në politikë.

Panelistët, po ashtu, theksuan rëndësinë e kuotës si instrument i cili ka dhënë rezultat për përfshirjen e grave në pozita udhëheqëse, po ashtu u propozua që një kuotë e tillë të reflektohet edhe në parti politike, duke kaluar nëpër ndryshime statutore, që në këtë mënyrë të krijohen mekanizma gjithëpërfshirës brenda partive politike.

Kryeministri i Kosovës, njëherësh kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se kur gratë janë të përjashtuara, atëherë vendi largohet nga demokracia dhe i ofrohet autokracisë. "Kudo në shoqëri ne gjejmë momente e vende në cilat gratë e ndihmojnë njëra-tjetrën, ndërkaq ne e kemi për detyrë t'i ndihmojmë ato kur ato e ndihmojnë njëra-tjetrën", ka thënë Kurti.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, gjatë fjalës së tij ka thënë se ndihet krenar që PDK-ja u ka dhënë grave më së shumti hapësirë në

vendimarrje në skenën politike. Krasniqi ka thënë se pas përfundimit të zgjedhjeve lokale, Partia Demokratike e Kosovës për herë të parë ka arritur të vendosë rekord të ri me vendosjen e grave në pozicione vendimmarrëse. "Këtë e them me krenari, me mburrje që në PDK sot pesë zonja të nderuara përfaqësuese tonat udhëheqin pesë asamble komunale, pesë parlamente lokale në komuna tepër të rëndësishme të Kosovës si Prizreni, Mitrovica, Vushtrria, Gjakova, Skenderaj. Përtej kësaj ne kemi emëruar dy nënkryetare komunash, përfshirë edhe kryeqytetin, gjë që s'ka ndodhur

më herët as në Prishtinë, as në Gjiilan", ka thënë ai.

Lideri i PDK-së ka theksuar se duhet ende angazhim që pozita e grave në shoqërinë tonë të shënojë përparim për t'u arritur objektivi i përbashkët i politikëbërësve. "Dua ta jap shembullin e Partisë Demokratike të Kosovës. Në zgjedhjet e kaluara ne përsëri kemi qenë partia që ka pasur numrin më të madh të grave kandidate për kryetare të komunave, kemi pasur numrin më të madh, por është numër ende i vogël sepse kanë qenë katër kandidate por, megjithatë, në komuna dhe qytete të

rëndësishme. Përtej kësaj, ne kemi pasur edhe numrin më të madh të grave që kanë udhëhequr listat e asambleve komunale, gjithsej tetë. Po ashtu, kemi pasur përtej kuotës rreth 38 për qind kandidate në listat për asamble", është shprehur ai. Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka thënë se si LDK kanë pasur tradicionalisht përfshirjen e gruas si të natyrshme edhe atë në kohë shumë të vështira si në kohët e viteve '90 e deri te pavarësia e Kosovës dhe pas saj. "Në Kosovë i kemi dy presidente gra. Po ashtu, kemi gra në parlament që s'kanë nevojë për kuotë gjinore. Këto për partitë politike janë sinjale të rëndësishme për ta rregulluar përfshirimin e gruas brenda vetes. Duam ta përshejtojmë përfshirjen e grave në të gjitha nivelet politike", ka thënë Abdixhiku.

E kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, derisa ka folur për luftën në Ukrainë, ka thënë se pasojat më të mëdha atje do t'i vuajnë gratë dhe fëmijët. "Jam i bindur që secila prej jush e të gjithë ne bashkë e dënojmë një luftë pushtuese të Rusisë, një sjellje shumë e keqe që e kemi parë edhe në të kaluarën. Pasojat më të mëdha do t'i vuajnë femrat dhe fëmijët e atij vendi. Unë besoj se të bashkuar do të vazhdojmë ta përmirësojmë pozitën e gruas në Kosovë", ka thënë Haradinaj.

Java e Gruas është një ngjarje vjetore në nivel vendi që mbledh në një mjedis ndëretnik më shumë se 120 gra dhe burra nga partitë politike, shoqëria civile, biznesi, media dhe akademja, me qëllim të zgjerimit dhe forcimit të kapaciteteve të grave udhëheqëse dhe mbështetjes së tyre për marrjen e pozicioneve më të mëdha drejtuese.



Protestojnë punëtorët e sigurimit fizik në KEK

PRISHTINË, 15 MARS (ER) - "Jemi të huazuar dhe jo të privatizuar", "Nuk lejojmë të shitemi tutje", ishin disa nga pankartat që mbanin në duar disa prej anëtarëve të Sindikatës "Mbrojtja dhe Siguria", e cila përfaqëson shërbimin e sigurimit fizik në KEK. Ata kanë protestuar të martën para Qeverisë së Kosovës dhe kanë kërkuar të drejtat e tyre që u takojnë me ligj.

Protestuesit kanë kërkuar që ta kthejnë kokën nga këta

punëtorë dhe të mos diskriminohen, në të kundërtën ata kanë paralajmëruar grevë që prej 24 marsit.

Kryetari i Shoqatës Sindikale "Mbrojtja dhe Siguria", Haki Azemi, ka thënë se qëllimi i protestës është që t'u thonë stop manipulimeve dhe diskriminimeve.

Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) ka dalë në përkrahje të kërkesave të tyre. "Punëtorët e Departamentit të Sigurimit

Fizik në KEK kërkojnë nga partneri social - qeveria - që t'i shqyrtojë dhe të merret seriozisht me kërkesat sindikale. Besojmë shumë dhe presim që kërkesat e drejta dhe të arsyeshme të punëtorëve të Departamentit të Sigurimit Fizik në KEK të shqyrtohen dhe punëtorëve t'u jepet mbështetja e duhur institucionale duke i realizuar kërkesat e tyre të drejta dhe të arsyeshme", është bërë me dije në reagimin e BSPK-së.



Investimet e FKPK-së kanë rënë rreth 4 për qind

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 MARS - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka pritur në takim përfaqësuesit e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), përkatësisht kryesuesin e Bordit Drejtues, Ruzhdi Morina, dhe drejtorin menaxhues Adrian Zalli.

Temë kryesore e takimit ishte informimi i drejtuesve të BQK-së me gjendjen e aktuale të investimeve të FKPK-së në tregjet financiare pas ngjarjeve të fundit në Ukrainë. Morina ka njoftuar se pas vitit 2021, kur investimet e FKPK-së kishin ngritje rreth 11 për qind, në këtë fillimvit, si për shkak të efekteve negative të pandemisë në zinxhirin furnizues, por sidomos nga lufta në Ukrainë, investimet e FKPK-së kanë njohur një rënie, që aktualisht është rreth 4 për qind.

Duke qenë se indekset kryesore në tregjet financiare aktualisht kanë shënuar rënie prej 15-përqindësh deri në 20 për qind, rënia prej 4-përqindësh në investimet e FKPK-së mund të



konsiderohet mjaft e përmbajtur, kryesisht si rezultat i masave mbrojtëse që Bordi Drejtues i ka marrë gjatë janarit dhe shkurtit të këtij viti.

Gjithashtu, Morina ka deklaruar se kjo rënie, edhe pse negative, në periudhën afatshkurtër nuk e dëmton qëllimin afatgjatë të FKPK-së, siç dëshmohet me të gjithë treguesit e performancës

së FKPK-së mbi tre muaj, që janë në terren pozitiv.

Po me këtë rast, Morina e ka njoftuar guvernatorin Mehmeti me masën e dytë që Bordi Drejtues e ka vendosur, duke e lansuar portofolin konservativ për kontribuuesit e moshës 63.5 vjeçare e më të moshuar.

Sipas kësaj mase, mjetet e tyre do të përllogariten të investuara në

Bonot e Thesarit të Republikës së Kosovës dhe asnjë kontribuues 18 muaj e më pak afër pensionimit nuk do të preket nga lëvizjet e tregjeve financiare. Guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti, pasi i falënderoi për informimin, i vlerësoi përpjekjet e Bordit Drejtues të FKPK-së për masat e ndërmarra, të cilat e kanë ulur rezikun dhe ndikimin

e këtyre lëvizjeve të kontribuuesit.

Guvernatori ka theksuar nevojën e takimeve të rregullta mes të dyja institucioneve, në mënyrë që situata të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme dhe që të sigurohet reagimi i duhur institucional në shërbim të mbrojtjes së interesave të kontributdhënësve.

Çmimet në shkurt u rritën mbi 7 për qind, mbrojtja e konsumatorit e forcon ekonominë



PRISHTINË, 15 MARS (ER) - Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ka shënuar Ditën Ndërkombëtare për të Drejtat e Konsumatorit, me temën "Mbrojtja e

konsumatorit dhe ngritja e çmimeve në Kosovë". Aty u tha se ky takim për synim ka ndërgjegjësimin e konsumatorëve në lidhje me të drejtën e tyre.

Dardan Abazi, hulumtues i lartë në INDEP, ka theksuar se do të vazhdojnë të jenë dritarja e vetme në mbrojtje të konsumatorëve. "Rritja e çmimeve ka rënduar një pjesë

të madhe të konsumatorëve", ka thënë ai.

Nijazi Shala nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit ka theksuar se kontrollat e çmimeve mund t'i ndihmojnë korporatat duke i eliminuar monopolin. "Kjo nuk është ekonomi e kontrolluar si në të kaluarën. Kontrollimi i çmimeve ishte shumë më i lirë në të kaluarën. Nëse varet nga importet, është shumë e vështirë në kontrollimin e çmimeve. Kosova ende nuk paraqet vend konkurrent ndërkombëtarisht. Kosova nuk paraqet vend me intensitet të lartë kapital. Mbrojtja e konsumatorit ka rëndësi të veçantë dhe mund të konsiderohet si kategori ekonomike. Mbrojtja e konsumatorit konsiston në forcimin e ekonomisë. Kontrollat e çmimeve mund të

ndihmojnë korporata duke eliminuar monopolin", ka thënë Shala, duke shtuar se janë në proces të ndryshimit të ligjit për mbrojtjen e konsumatorit.

Ilir Berisha nga Agjencia e Statistikave e Kosovës ka pohuar se roli i tyre është publikimi i statistikave. Ai ka thënë se është vërejtur një ngritje e çmimeve rreth 7.3 për qind. "Lëvizjet e çmimeve kanë pasur një ngritje dhe Agjencia e Statistikave përcjellë listën e çmimeve në baza mujore. Së fundmi agjencia ka publikuar indeksin për shkurt ku është vërejtur rritje e çmimeve që nuk ka qenë shumë e lartë, diku 7.3 për qind", është shprehur Berisha. Albion Ujkashi nga Rrjeti i Shitësve me Pakicë ka thënë se është e rëndësishme që konsumatori të konsiderohet pjesë e domosdoshme e të bërit biznes.

Nënshkruhet memorandumi për implementimin e vendosjes së ngjitësve

PRISHTINË, 15 MARS (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, zëvendësministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Hysen Durmishi, drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit, Sami Mazreku, si dhe Genc Hamzaj nga Agjencia e Regjistrimit Civil,

kanë nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit për implementimin e projektit për vendosjen e ngjitësve (stikersave) në xhamat e automjeteve, projekt ky i mbështetur në tërësi nga BKS-ja. Drejtori i BKS-së, Sami

Mazreku, ka falënderuar guvernatorin e BQK-së, Fehmi Mehmetin, zëvendësministren Durmishi dhe ARC-në, për angazhimin që kanë pasur ditët e fundit për implementimin e këtij projekti shumë të rëndësishëm, i cili për qëllim ka uljen e numrit të automjeteve të paregjistruara në vend.



Fati i Ukrainës u vulos në Budapest, 30 vjet më parë



E ardhmja e Ukrainës si shtet është në fije të perit. Pushtimi rus s'duhet të kishte ndodhur asnjëherë. Ukraina është bërë viktimë e rifillimit të politikës së Luftës së Ftohtë, për shkak të udhëheqjes së paafte dhe vendimarrjes së keqe. Duke bërë përgjegjës NATO-n dhe Rusinë për konfliktin aktual, ne duhet të bëjmë një hap pas, dhe të pyesim nëse mund ta kishim parandaluar këtë katastrofë të tmerrshme humanitare. Ukraina është shndërruar në një fushë-betejë të politikës së superfuqive. Që kur shpalli pavarësinë nga Bashkimi Sovjetik në vitin 1991, janë fuqitë e mëdha botërore, ato që kanë vendosur mbi fatin e këtij vendi. A mund ta kishim shmangur luftën e sotme? Nuk do ta dimë kurrë me siguri.

Por bazuar në historinë e fuqive bërthamore që nuk përfshihen në një luftë të plotë, mund të supozojmë se gjërat do të kishin qenë sot ndryshe, nëse Ukraina nuk do të kishte hequr dorë nga armët e saj bërthamore.

Ukraina kishte arsenalin e tretë bërthamor më të madh në botë. Por ajo i dorëzoi të gjitha armët e saj bërthamore, si pjesë e Memorandumit të Budapestit të vitit 1994. Por pse Ukraina i dorëzoi

armët e saj bërthamore? Këtu ndikoi një vendimarrje politike dritëshkurtër, dhe gatishmëria për t'u besuar superfuqive.

Ukraina, vendi i dytë më i madh i Bashkimit Sovjetik, votoi në një referendum mbi pavarësinë më 1 dhjetor 1991. 90 për qind e ukrainasve votuan në favor të pavarësisë totale.

Bashkimi Sovjetik ishte një fuqi bërthamore. Një e treta e armëve bërthamore të Bashkimit Sovjetik, prodhoheshin dhe ruheshin në Ukrainë, ose 1700 bomba atomike. Përveç Ukrainës, edhe Bjellorusia dhe Kazakistani trashëguan armë bërthamore nga Bashkimi Sovjetik. Këto armë shërbejnë si një pengesë për pushtimet e ardhshme dhe konfliktet në shkallë të plotë. Megjithatë, mirëmbajtja e tyre është shumë e kushtueshme.

Në fillimin e viteve 1990, varfëria e pllakosi Ukrainën, Kazakistanin dhe Bjellorusinë, dhe miliona njerëz ishin në pragun e urisë. Paratë mungonin. Dhe ndërsa kostoja e mbajtjes së armëve bërthamore u rrit, Kazakistani dhe Bjellorusia ishin gati t'ia dorëzonin Rusisë teknologjinë e tyre bërthamore.

Rusia mund t'i ndihmonte të dyja vendet pasi kishte teknologjinë dhe burimet financiare. Ndërkohë

Ukraina ishte në dilemë. Ukrainasit druhashin se do të humbnin mekanizimin e tyre frenues kundër një sulmi të ardhshëm. Por vetëm disa njerëz në botë e ndanin këtë frikë.

Njëri prej tyre ishte Xhon Mershaimer, politolog dhe profesor i Universitetit të Çikagos. Në vitin 1993, ai parashikoi se Ukraina do të rrezikohej nga një sulm rus, nëse s'do të kishte armët e saj bërthamore. Si për t'i ndërlikuar gjërat më shumë, Rusia njihet mirë të gjitha aspektet e teknologjisë bërthamore të Ukrainës, përfshirë edhe kodet për lëshimin e raketave. Dhe rusët ishin të vendosur të mos e ndanin këtë informacionin me ukrainasit. Natyrisht, ukrainasit mund t'u kërkonin ndihmë shteteve të tjera bërthamore si Shtetet e Bashkuara, Franca, Kina dhe Britania e Madhe për programin e tyre bërthamor. Por edhe superfuqitë e tjera nuk ishin të gatshme ta ndihmonin Ukrainën.

Madje SHBA-ja shkoi një hap më tej, duke i premtuar Ukrainës ndihmë ekonomike, në këmbim të dorëzimit tek Rusia të armëve të saj bërthamore. Ukraina u josh shumë nga ky propozim. Asaj i duheshin paratë, por kërkonte edhe një garanci të plotë, se Rusia nuk do të

pushtonte më.

Cila ishte zgjidhja? Ukraina mori një paketë financiare prej 300 milionë dollarësh nga Shtetet e Bashkuara, ndërsa Rusia ra dakord të heqë dorë nga 2.5 miliardë dollarë borxhe për gazin dhe naftën, duke premtuar gjithashtu edhe furnizimin e ardhshëm me karburant bërthamor për termocentralet ukrainase.

Pra superfuqitë i bënë Ukrainës një ofertë që nuk mund ta refuzonte. Por presidenti ukrainas Leonid Kravçuk, po hezitonte ta nënshkruante atë marrëveshje. Administrata Klinton ushtroi presion shtesë mbi Ukrainën, duke pretenduar se refuzimi për ta nënshkruar marrëveshjen, vinte në rrezik marrëdhëniet SHBA-Ukrainë.

Në Marrëveshjen Trepalëshe të Moskës të janarit 1994, presidenti rus Boris Jelcin ushtroi një presion të mëtejshëm mbi Kravçuk. Ai e siguroi se Rusia nuk do ta pushtonte Ukrainën, dhe rusët ishin të gatshëm të nënshkruanin një marrëveshje, që e premtonte zyrtarisht këtë gjë.


Kravçuk u bind më në fund të nënshkruante paktin. Vendimi i Ukrainës, Kazakistanit dhe Bjellorusisë për të dorëzuar tek

Rusia armët e tyre bërthamore, në këmbim të disa garancive nga superfuqitë, u nënshkrua në Budapest më 5 dhjetor 1994. Kjo marrëveshje njihet si Memorandumi i Budapestit mbi Garancitë e Sigurisë.

Tre vendet morën garanci nga Rusia, Britania e Madhe dhe SHBA-ja se do të respektoheshin kufijtë e tyre, se superfuqitë nuk do të ndërhyjnë ushtarakisht në këto vende, se nuk do të ndikonin në politikën e tyre nëpërmjet presionit ekonomik, dhe nuk do të përdorin armëbërthamore kundër tyre.

Lista e premtimeve, zbuti shumë nga frikërat që kishte Ukraina. Vendet e tjera të rëndësishme bërthamore, si Kina dhe Franca, nuk e nënshkruan memorandumin. Ato nënshkruan dokumente të veçanta, që shprehnin mbështetje për çarmatimin bërthamor.

Sot e dimë se besimi ndaj superfuqive, ishte një vendim dritëshkurtër dhe i gabuar. Si NATO ashtu edhe Rusia, kanë ndërhyrë shumë herë në politikën e brendshme të Ukrainës, dhe sot jemi në një fazë ku janë njerëzit e zakonshëm, ata që po paguajnë koston e marrëzisë seliderëve të tyre. / *History of Yesterday* – Bota.al



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Duka, pas rizgjedhjes kryetar i FShF-së: Dua t'i lë pas të gjitha shpifjet dhe ofendimet

TIRANË, 15 MARS - Armand Duka është rizgjedhur sërish president i Federatës Shqiptare të Futbollit. Duka e ka siguruar mandatin e gjashtë në krye të FShF-së pas një procesi të kontestuar fuqishëm nga kandidati tjetër Dritan Shakohoxha i cili nuk ishte i pranishëm në këtë asamble, duke e konsideruar joligjore, jostatusore dhe fals. Duka kishte përballë në këto zgjedhje dy rivalë, Shakohoxhën dhe trajnerin e mirënjohur Sulejman Starova. Duka mori 37 vota, Starova 4, ndërsa dy vota u shpallën të pavlefshme. "Jam i emocionuar dhe i

obliguar për këtë votëbesim. Secili mund të ketë vërejtje për mua, por do t'i respektoj dhe do të mundohem t'i korrigjoj gjatë drejtimit të katërvjeçarit të radhës. Kam dëgjuar ofendime, por do t'i shmang me sportivitet shpifjet dhe ofendimet që do të vijnë. Dëshiroj të lë pas çfarë kemi kaluar në këta muaj për t'u përqendruar te futbollit. Ju falënderoj për besimin dhe do të jem krah jush në katër vjetet e ardhshme", ka deklaruar Duka. Ndërsa kandidati për president i FShF-së, Dritan Shakohoxha, ka reaguar pas zhvillimit të

Asamblesë të FShF-së e cila rizgjodhi Armand Dukën president të saj. "Siç kam deklaruar edhe të hënën, unë do ta vazhdoj betejën ligjore. Besoj shumë që votimi i sotëm nuk do të legjitimohet. FShF ka përdorur politikën e faktit të kryer e cila mund t'i duket me vlerë sot, por ditët në vijim do të shohim të gjithë që do të jetë e pavlerë. Gjykatat kanë folur dhe do të flasin përsëri besoj, duke ruajtur të njëjtin standard si në dy rastet e mëparshme. Në fund, drejtësia do të vendoset dhe futbollit do të flasë me votat e anëtarëve të familjes sonë", ka deklaruar Shakohoxha.



Përballje interesante në Ligën Unike

PRISHTINË, 15 MARS - Në mesjavë zhvillohet java e 13-të në Ligën Unike. Takimi i parë është ndërmjet Kamza Basket dhe Rahovecit. Skuadra e Kamzës ka dy fitore dhe dhjetë humbje, ndërsa Vreshtarët kanë pesë fitore e shtatë humbje dhe janë në formë shumë të mirë, duke kërkuar të renditen sa më lart për garat e rregullta. Kampioni Golden Eagle Ylli do të ndeshet me Tirana Neptun. Ylli është në formë të jashtëzakonshme në Ligën Unike me 11 fitore dhe një humbje, ndërsa tiranasit kanë gjashtë fitore e gjashtë humbje. Të enjten Peja do të ndeshet me Vllazninë. Pejanët kanë nëntë fitore dhe tri humbje, kurse shkodranët kanë dy fitore e dhjetë humbje. Ndashja e fundit dhe më e barabarta e kësaj xhiroje në Ligën Unike zhvillohet ndërmjet Teutës dhe Prizrenit 16. Durrsakët kanë gjashtë fitore e gjashtë humbje, ndërsa prizrenasit kanë shtatë

fitore e pesë humbje, andaj shihet si një përballje rivalizuese ndërmjet skuadrave që synojnë të renditen sa më lart për garat e rregullta, ndërsa zhvillohen 14 xhiro.

Dy derbi në xhiron e fundit te femrat

Në mesjavë do të zhvillohet xhironja e dhjetë në Ligën Unike të femrave, apo e fundit për garat e rregullta, ku do të përcaktohet renditja përfundimtare dhe gjysmëfinalët e "play-off"-it. Takimi i parë është ndërmjet skuadrave tiranase, Tiranës dhe Partizanit. Tirana numëron nëntë humbje në nëntë ndeshje të zhvilluara, kurse vashat e Partizanit kanë dy fitore dhe shtatë humbje. Pasi u përballën në Superligën e Kosovës, Bashkimi dhe Penza, kësaj radhe sfidohen në Ligën Unike. Prizrenaset kanë pesë fitore e katër



LIGA UNIKE E MESHKUJVE - Java 13

Të mërkurën takohen:
17:00 Kamza Basket - Rahoveci
19:00 Golden Eagle Ylli - Tirana Neptun

Të enjten takohen:
17:00 Peja - Vllaznia
19:00 Teuta - Prizreni 16

LIGA UNIKE E FEMRAVE - JAVA 10

Të mërkurën takohen:
18:00 Tirana - Partizani
19:00 Bashkimi - Penza

Të enjten takohen:
19:30 Prishtina - Flamurtari

humbje, ndërsa pejanet shtatë fitore e dy humbje, prandaj pritet një ndeshje shumë interesante dhe rivalizuese. Të enjten zhvillohet ndeshja e fundit e kësaj xhiroje dhe e fundit për garat e rregullta mes Prishtinës dhe Flamurtarit. Vashat prishtinase kanë gjashtë fitore e tri humbje, ndërsa skuadra nga Vlora ka shtatë fitore e dy humbje.

Kupa e Kosovës rikthehet me duele të 'nxehta'

PRISHTINË, 14 MARS - Kupa e Kosovës në futboll rikthehet në mesjavë me ndeshjet e fazës çerekfinale. Fituesit e trofeut në edicionin e kaluar, Llapi e mirëpret Gjilanin në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë. Këto dy skuadra u ndeshën edhe në fundjavë me ndeshjen e cila u mbyll baras 1-1 në stadiumin me bari sintetik në Gjilan dhe i takoi javës së 25-të kampionale. Takim tjetër i

zjarrtë do të luhet edhe në Suharekë. Ballkani dhe Prishtina synojnë gjysmëfinalen. Suharekasit po kalojnë një sezon fantastik, ndërsa kryeqytetasit kanë gjetur rrugën e fitoreve pas një serie të gjatë negative. Drita, në anën tjetër, luan me Ulpianën në shtëpi, kurse sfida tjetër është në mes të skuadrës së Ligës së Parë, Ramiz Sadikut dhe ekipit të Ligës së Dytë,

KEK-ut. Të gjitha ndeshjet zhvillohen me fillim nga ora 13:00.

KUPA E KOSOVËS

Të mërkurën takohen:
Ballkani - Prishtina
Llapi - Gjilani
Drita - Ulpiana

Të enjten takohen:
Ramiz Sadiku - KEK-u



Bach: Masat ndaj Rusisë dhe Bjellorusisë mund të shtohen

LOZANË, 15 MARS - Pas fillimit të luftës në Ukrainë, Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC) kërkoi nga shtetet dhe federatat ndërkombëtare të mos lejojnë sportistët nga Rusia dhe Bjellorusia të marrin pjesë në ngjarje

sportive. Më pas u mor vendimi që këto dy shtete të përjashtohen nga Lojërat Paraolimpike Dimërore "Pekin 2022". Presidenti i IOC, Thomas Bach, ka thënë se masat mund të shtohen në të ardhmen. "Për

momentin masat ndaj Rusisë e Bjellorusisë do të qëndrojnë këto që janë në fuqi, por kemi lënë të hapur çdo mundësi për ndryshimin e sanksioneve në të ardhmen. Për këtë gjë kemi pasur mjaft diskutime në këshill", ka thënë Bach.

Më tej, numri një i olimpizmit botëror ka shtuar: "Të shohim nëse do të ketë një shtim të masave ndaj këtyre dy vendeve, por do të shohim se kur do të përfundojë lufta në Ukrainë. Në po monitorojmë situatën dhe të shohim nëse



do të ketë një etapë tjetër të dënimeve".

KE i FFK-së dënon presionet dhe shantazhet që po u bëhen delegatëve

PRISHTINË, 15 MARS (ER) - Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës ka njoftuar se ditët e fundit ka pranuar informata dhe ankesa nga delegatët dhe anëtarët e FFK-së se po u bëhet presion nga persona jashtë sportit në mënyrë që të pengohet kuvendi i rregullt i thirru për 6 prill. Në njoftimin e lëshuar nga FFK-ja, thuhet se Komiteti Ekzekutiv i siguron të gjithë se do të ketë proces të rregullt për kryetar të Federatës. "Komiteti Ekzekutiv qysh prej vendimit të datës 2 mars 2022, me caktimin e datës së Kuvendit të Rregullt Zgjedhor, e sidomos në ditët e fundit, ka pranuar shumë informata dhe ankesa nga delegatët dhe anëtarët e FFK-së se po u bëhet presion nga persona dhe struktura jashtë sportit e futbollit, në mënyrë që ta pengojnë mbarrëvajtjen e rregullt të kuvendit të thirrur për datën 6 prill. Komiteti Ekzekutiv i



FFK-së shpreh mbështetje për të gjithë anëtarët dhe delegatët e FFK-së dhe u kërkon që këto presione, shantazhe dhe forma të ndryshme të ndikimit, t'i raportojnë në organet përkatëse në FFK-së dhe organet shtetërore të Republikës së Kosovës, si Policia dhe Prokuroria. Komiteti si organ ekzekutiv i FFK-së do ta mbrojë dinjitetin e delegatëve dhe anëtarëve të FFK-së, njëherësh i siguron të gjithë

anëtarët e saj dhe delegatët se do t'i adresojë të gjitha shqetësimet dhe presionet e bëra ndaj tyre tek organet përkatëse, dhe tashmë i kemi informuar organet kompetente të Kosovës, UEFA-s dhe FIFA-s. Komiteti Ekzekutiv i siguron të gjithë se do të kemi një proces të rregullt e fer deri në përfundim të kuvendit të radhës të datës 6 prill", thuhet në njoftimin e lëshuar nga Federata e Futbollit e Kosovës.

Drejtuesit e KOK-ut pritën ambasadorën për sport të Francës, Laurence Fischer

PRISHTINË, 15 MARS - Drejtuesit e KOK-ut, kryetari Ismet Krasniqi dhe sekretari i përgjithshëm, Besim Aliti, kanë pritur ambasadorën për sport në Republikën e Francës, Laurence Fischer, e cila po e viziton Kosovën. Presidenti Krasniqi, duke falënderuar ambasadorën Fischer për vizitën bërë KOK-ut, e njoftoi me aktivitetet dhe sukseset, me theks të veçantë medaljet e arta olimpikë. Presidenti theksoi se synimet e tanishme janë Lojërat Olimpikë "Paris 2024", ku KOK-u po i mbështet me bursa olimpikë 22 sportistë, nga të cilët pritet janë të fitohen sa më shumë norma olimpikë, më pas edhe medalje. Ambasadorja Fischer vlerësoi lart të arriturat e sportistëve tanë, derisa shprehu kënaqësinë që Franca do t'i organizojë Lojërat e ardhshme Olimpikë, duke shtuar se mikpritja për ekipin olimpik të Kosovës do të jetë në nivel të lartë. "Palët



diskutuan edhe për mundësinë që sportistët tanë të marrin pjesë në kampe të ndryshme që organizohen në Francë, para LO "Paris 2024". Ambasadorja shoqërohej në takim edhe nga përgjegjësja për bashkëpunim me Ambasadorën e Francës, Cecilia Maronnier, si dhe

menaxherja e projektit në delegacionin për sport të Ministrisë së Francës për Evropë dhe Punë të Jashtme, Marie Roy, kurse nga KOK-u në takim mori pjesë edhe zyrtarja për marrëdhënie ndërkombëtare, Rejhan Halili", thuhet në njoftimin e KOK-ut.

SHKURT

Erikseni rikthehet te Danimarka 9 muaj pas sulmit në zemër

Christian Eriksen rikthehet te Danimarka 9 muaj pasi pësoi një sulm në zemër në fushën e blertë. Mesfushori, i cili nga Interi kaloi në Premierë Ligë te Brentford, ka nisur të luajë së fundmi. Kasper Hjulmand, trajneri i Danimarkës, ka vendosur ta ftojë edhe mesfushorin për ndeshjet miqësore kundër Holandës dhe Serbisë më 26 dhe 29 mars.

Dzyuba refuzon ftesën e Rusisë

Ylli rus Artem Dzyuba ka refuzuar ftesën nga kombëtarja e Rusisë dhe ka thënë se nuk dëshiron të jetë pjesë e kombëtares ruse në këtë kohë. Lojtari i Zenit St. Petersburg ka familjarë në Ukrainë dhe agresioni rus i nisur atje e ka shqetësuar edhe atë. Trajneri Valeriy Karpin ka konfirmuar se Dzyuba ka kërkuar të mos fitohet me kombëtaren ruse për kampin stërvitor këtë muaj. Arsyeja është lufta e paarsyeshme e nisur në Ukrainë. Rusia do të grumbullohet për kamp stërvitor këtë muaj pavarësisht prej faktit se FIFA dhe UEFA e kanë suspenduar nga secili kompeticion. Vendimin e FIFA-s dhe UEFA-s rusët e kanë apeluar në CAS dhe janë në pritje të një përgjigje. Përveç Dzyuba, kundër luftës në Ukrainë më parë shprehej edhe portieri i kombëtares ruse.

Guardiola: Futbollit është i vetmi sport ku nuk fiton gjithmonë më i miri

Kampioni në fuqi i Premierë Ligës, Manchester City, nuk arriti me shumë se një barazim ndaj Crystal Palace (0-0). Trajneri Pep Guardiola ka thënë se në futboll nuk fiton gjithmonë më i miri. "Ne e analizuar lojën si gjithmonë. Lojtarët janë mjaftueshëm të rritur të gjithë për ta ditur pse nuk mundëm të fitonim. Sidoqoftë, ne bëmë gjithçka që mundëm dhe luajtëm shumë mirë. Ajo që dua nga ekipi im është që të bëjë më shumë dhe më mirë se kundërshtarët. Kjo është ajo që ndodhi. Ne nuk mund të fitojmë gjithmonë. Futbollit është i vetmi sport ku mund të jesh më i miri në gjithçka, pothuajse në çdo repart, megjithatë nuk fiton. Kështu që urime për Crystal Palacen. Bëri paraqitje të jashtëzakonshme. Një ekip fantastik, që mbron shumë mirë", ka thënë Guardiola.

PSG-ja me ofertë të majme për Leao

Paris Saint Germain është gati ta rrëmbejë futbollistin më në formë të Milanit, Rafael Leao. "La Gazzetta dello Sport" shkruan se klubi parisien ka gati një ofertë prej 70 milionë eurosh për klubin kuqezi dhe një pagë prej 6 milionë eurosh neto në sezon për anësorin portugez. Për momentin prioriteti i Leaos është ta mbyllë përfundimisht kapitullin Sporting, pasi CAS ka vendosur që Lille duhet ta paguajë klubin portugez për prishjen e njëanshme të kontratës në vitin 2018, para se të transferohej në Ligën 1. Këtë sezon futbollisti portugez ka shënuar 11 gola me fanellën e kuqezinjve, duke e ndihmuar që ta marrë kreun e Serisë A.

Gotze ëndërron kalimin në Premierë Ligë

Mario Gotze ka kontratë me PSV-në deri në vitin 2024, por është i interesuar të transferohet në Premierë Ligë. Ëndrra e yllit gjerman është që ta ftojë Ligën e

Kampionëve. "Gjithmonë e kam bërë misionin tim që me të vërtetë dua ta ftoj Ligën e Kampionëve. Kjo do të ishte diçka që unë do të doja të arrij ende. Tani kam bërë hapin nga

Bundesliga në Holandë për të parë dhe përjetuar diçka të re. Njohja vetëm Bundesligën, në të cilën luajta për 10 vjet. Megjithatë, me qëllimin tim të lartpërmendur, dua të luaj në

nivelin më të lartë në Evropë, mundësisht në Itali ose Spanjë. Premierë Liga me garimin e saj të ekuilibruar gjithashtu më tërheq mua", ka thënë Gotze.



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121; në mbështetje të rregullit 19 dhe 20 të Rregullores së punës Nr. 01/2018 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; si dhe në mbështetje të Rregullores Nr. 04/2015, për Procedurat e rekrutimit, të emërimit dhe të punës provuese të stafit të Gjykatës Kushtetuese, Sekretariati shpall:

KONKURS Për plotësimin e tri (3) vendeve të lira të punës

1.
Pozita: Zyrtar për Protokoll
Kodi: SP-ZKI-05
Numri i pozitave: 1 (një)
Kohëzgjatja e emërimit: 1 karrierës (pa afat)
Puna provuese: 1 (një) vit

Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës:

Nën mbikëqyrjen e drejtorit të Zyrës për Komunikim dhe Informim, dhe në bashkërendim me Shefin e Kabinetit të Kryetarit, si dhe me Këshilltarin për Marrëdhënie Ndërkombëtare, përkujdeset dhe ndërmerr masat e nevojshme protokollare për vizitat në Gjykatë dhe për vizitat jashtë vendit të përfaqësuesve të Gjykatës. Në bashkërendim me drejtorin e Zyrës për Informim dhe Komunikim, përkujdeset për informimin e medieve përkitazi me aktivitetet protokollare në Gjykatë dhe për Gjykatën.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Organizon ceremonitë e pritjes dhe të përcjelljes, si dhe zbaton të gjitha rregullat protokollare gjatë vizitave të delegacioneve;
- Bashkëpunon dhe bashkërendon punën me shërbimet e tjera protokollare të subjekteve të tjera institucionale, për takimet e Kryetarit të Gjykatës dhe të gjyqtarëve, me përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme vendëse dhe ndërkombëtare;
- Përcjell kalendarin e festave shtetërore dhe, në koordinim me Shefin e Kabinetit, me Këshilltarin për marrëdhënie ndërkombëtare, si dhe të drejtorit të Zyrës për Informim dhe Komunikim, përkujdeset për përpilimin dhe për dërgimin e telegrameve dhe të ftesave zyrtare në emër të Kryetarit dhe në emër të gjyqtarëve të Gjykatës për gjykatat homologe, si dhe për organet e tjera shtetërore dhe ndërkombëtare;
- Përkujdeset për përgatitjen dhe për dukjen e dhuratave zyrtare të Gjykatës;
- Në koordinim me Shefin e Kabinetit, me Këshilltarin për marrëdhënie ndërkombëtare, si dhe të drejtorit të Zyrës për Informim dhe Komunikim, përgatit dhe harton listën e pjesëmarrësve në takimet zyrtare dhe në pritjet e Kryetarit të Gjykatës;
- Harton procesverbale nga takimet dhe nga vizitat zyrtare në Gjykatë;
- Mirëmban arkivin e materialeve fotografike, video dhe audio, nga aktivitetet në Gjykatë dhe nga vizitat zyrtare jashtë vendit; dhe
- Kryen punë të tjera profesionale sipas kërkesës së drejtorit të Zyrës për Komunikim dhe Informim, Kryetarit dhe Gjyqtarëve.

Kualifikimet minimale, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Përgatitja shkollore superiore në lëmin e marrëdhënieve ndërkombëtare, shkenca juridike, protokoll, komunikim apo të ngjashme; dhe
- Të paktën 3 (tri) vjet përvojë pune në institucionet/organizatat vendëse, ose në institucionet ndërkombëtare, të ndërlidhura me lëmin e kësaj detyre.

Zyrtari për protokoll duhet të ketë aftësi të shkëlqyeshme organizative dhe planifikuese dhe të jetë i gatshëm të punojë me orar fleksibil të punës; të ketë aftësi komunikimi të zhvilluara mirë (në mënyrë verbale dhe me shkrim); të ketë përvojë për administrimin e postës elektronike dhe për përdorimin e internetit; të ketë aftësi për të punuar me efikasitet nën presion kohor; të ketë aftësi për caktimin e prioriteteve dhe për përfundimin e disa detyrave njëkohësisht; të ketë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur me mbikëqyrje minimale, si dhe në një mjedis ekipor; të ketë aftësi të shkëlqyeshme për përdorimin e kompjuterit, veçanërisht të programeve MS Word dhe Excel; të njohë mirë gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze; njohuria e gjuhës serbe do të jetë përparësi; përfshirë edhe aftësi të zhvilluara për hartimin e dokumenteve.

2.
Pozita: Zyrtar për Multimedia dhe Ueb-faqe
Kodi: SP-ZKI-06
Numri i pozitave: 1 (një)
Kohëzgjatja e emërimit: 1 karrierës (pa afat)
Puna provuese: 1 (një) vit

Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës:

Nën mbikëqyrjen e drejtorit të Zyrës për Komunikim dhe Informim (ZKI), Zyrtari për Multimedia dhe Ueb-faqe monitoron shkrimet dhe video-materialet informative në mediat/rrjetet sociale përkitazi me punën e Gjykatës, menaxhon sektorin e njoftimeve në ueb-faqen e Gjykatës dhe me faqet e Gjykatës në mediat/rrjetet sociale, përgatit dhe publikon video-materiale informative në ueb-faqen e Gjykatës dhe në faqet e Gjykatës në mediat/rrjetet sociale, identifikon mundësitë për promovimin e punës së Gjykatës në mediat/rrjetet sociale.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Monitorimi i shkrimeve dhe i video-materialeve informative të publikuara në mediat/rrjetet sociale përkitazi me punën dhe aktivitetet e Gjykatës;
- Përgatitja e raporteve periodike përkitazi me çështjet e trajtuara në mediat/rrjetet sociale rreth punës dhe aktivitetet të Gjykatës;
- Postimi dhe përditësimi i njoftimeve përkitazi me punën dhe aktivitetet e Gjykatës Kushtetuese në ueb-faqen e Gjykatës dhe në faqet e Gjykatës në mediat/rrjetet sociale;
- Transmetimi i drejtpërdrejt i konferencave për shtyp, i seancave dëgjimore, i video-intervistave dhe i video-materialeve të tjera informative në faqet e Gjykatës në mediat/rrjetet sociale, në konsultim me drejtorin e ZKI;

- Menaxhimi i seksionit të komenteve dhe pyetjeve në faqet e Gjykatës në mediat/rrjetet sociale;
- Përgatitja dhe disenjimi i tabelave statistikore dhe video-materialeve informative të metrazhit të shkurt/gjatë përkitazi me punën dhe aktivitetet e Gjykatës, dhe promovimi i tyre në faqet e Gjykatës në mediat/rrjetet sociale;
- Identifikimi i mundësive dhe hartimi i propozimeve për promovimin e punës dhe aktivitetet të Gjykatës në mediat/rrjetet sociale;
- Kryen punë të tjera profesionale sipas kërkesës së drejtorit të Zyrës për Komunikim dhe Informim.

Kualifikimet minimale, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diplomë universitare në fushën e komunikimit dhe gazetarisë, shkencat sociale apo në fusha të tjera relevante;
- Së paku 4 (katër) vjet përvojë punë profesionale në lëmin e komunikimit dhe monitorimin e mediave/rrjeteve sociale në institucione apo në organizata ndërkombëtare;
- Njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës shqipe dhe angleze në të folur dhe në të shkruar; Njohuria e gjuhës serbe është përparësi;
- Aftësi të shkëlqyeshme të punës me kompjuter, me programe/aplikacione për përpunimin e materialeve foto dhe video, në përdorimin e internetit dhe të platformave/rrjeteve sociale;

Kandidati për pozitën e Zyrtarit për Multimedia dhe Ueb-faqe duhet të ketë: aftësi komunikimi të zhvilluara mirë; aftësi për të punuar me efikasitet nën presion kohor; aftësi të shkëlqyeshme organizative dhe planifikuese; aftësi për caktimin e prioriteteve dhe për përfundimin e disa detyrave njëkohësisht; aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur, si dhe në një mjedis ekipor; aftësi të shkëlqyeshme për përdorimin e kompjuterit, postës elektronike, internetit dhe veçanërisht të platformave/rrjeteve të ndryshme sociale; si dhe të ketë përvojë në përdorimin e programeve kompjuterike për përgatitjen e foto/video materialeve informative;

3.
Pozita: Përkthyes nga shqipja në anglisht e serbisht dhe anasjelltas
Kodi: SP-DPP-06
Numri i pozitave: 1 (një)
Kohëzgjatja e emërimit: 1 karrierës (pa afat)
Puna provuese: 1 (një) vit

Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës:

Përkthimi me shkrim dhe i atypëratyshëm i teksteve, i materialeve, i shkresave, i dokumenteve dhe i ligjeve nga shqipja, anglishtja e serbishtja dhe anasjelltas, si dhe ofrimi i përkrahjes cilësore për përkthimin, duke u përkujdesur për dukjen e dokumentit të përkthyer në përputhshmëri me dokumentin origjinal, nën mbikëqyrjen e drejtorit të Departamentit të Përkrahjes Profesionale. Përkthimi i atypëratyshëm nga shqipja, anglishtja e serbishtja dhe anasjelltas gjatë takimeve dhe seancave të punës në Gjykatën Kushtetuese.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Përkthen me shkrim materiale dhe dokumente të Gjykatës Kushtetuese nga gjuha shqipe në atë angleze e serbe dhe anasjelltas;
- Përkthim i atypëratyshëm gjatë takimeve dhe gjatë seancave të Gjykatës nga gjuha shqipe në atë angleze e serbe dhe anasjelltas;
- Përkujdeset për strukturën e fjalëve dhe të fjalive në dokumentet e përkthyer;
- Ndihmon dhe bashkëpunon me redaktorët/lektorët e Gjykatës në përcaktimin dhe në harmonizimin e terminologjisë së teksteve të përkthyer;
- Ndihmon dhe shoqëron gjyqtarët në takime pune dhe vepron si përkthyes/shpjegues; dhe
- Kryen edhe punë të tjera, sipas kërkesës së drejtorit të Departamentit të Përkrahjes Profesionale.

Kualifikimet minimale dhe përvoja e përgjithshme:

- Përgatitje universitare, preferohet në fushën Filologjike dhe Juridike;
- Së paku 2 (dy) vjet përvojë përkatëse profesionale në përkthime.

Përkthyesi duhet të jetë energjik, të ketë shkathtësi të mira ndërnjerëzore dhe të jetë i gatshëm të punojë me orar fleksibil të punës. Shkathtësia dhe aftësia në përdorimin e kompjuterit dhe të softuerëve aplikativë, si: MS Word, duke përfshirë përpunimin e avancuar të tekstit, MS Excel dhe MS Outlook, është e domosdoshme.

Informata të përgjithshme për kandidatët:

Përcaktimi i pagës për pozitën e shpallur, bëhet në përputhje me Rregulloren e punës dhe me vendim të Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese ofron mundësi të barabarta punësimi dhe mirëpret aplikacionet nga pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe nga kandidatët femra. Politika e përfaqësimit gjinor dhe e të gjitha komuniteteve të Kosovës do të zbatohet gjatë procedurës së rekrutimit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura e konkurrimit

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar nga një biografi profesionale, një letër motivuese dhe dokumentacionin përkatës për përgatitjen shkollore dhe për përvojën e kërkuar të punës.

Forma e aplikacionit mund të merret në kopje fizike në recepcionin e Gjykatës Kushtetuese dhe mund të shkarkohet nga ueb-faqja e Gjykatës Kushtetuese: www.gjk-ks.org.

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, mund të dërgohet nëpërmjet e-mailit në adresën: gjk.burimetnjerëzore@gjk-ks.org, nëpërmjet shërbimit postar, apo të dorëzohet në Departamentin e Administratës dhe Burimeve Njerëzore të Gjykatës Kushtetuese (DABNJ) në kopje fizike.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në ueb-faqen e Gjykatës si dhe shpalljes publike duke filluar nga data 16/03/2022 deri më datën 30/03/2022, që konsiderohet ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Data e fundit për pranimin e aplikacioneve është 30/03/2022, deri në ora 16.00.

Shënim:

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Shodno članu 12. Zakona o Ustavnom sudu Republike Kosovo, br. 03/L-121, pravilu 19. i 20. Poslovnika o radu Ustavnog suda Republike Kosovo, br. 01/2018, kao i u saglasnosti sa Uredbom br. 04/2015 o postupcima zapošljavanja, imenovanja i probnog rada za osoblje Ustavnog suda, Sekretarijat raspiše:

KONKURS za tri (3) slobodno radno mesto

1.
Pozita: Službenik za protokol
Kod: SP-ZKI -05
Broj pozicija: 1 (jedan)
Trajanje imenovanja: Karijerno (neodređeno)
Probni rad: 1 (jedna) godina

Opšti opis pozicije:

Pod nadzorom direktora Kancelarije za komunikacije i informisanje, u koordinaciji sa šefom kabineta predsednika i sa savetnikom za međunarodne odnose, stara se i preuzima neophodne protokolarne mere za posete Sudu i za posetu u inostranstvu predstavnika Suda. U koordinaciji sa direktorom Kancelarije za komunikacije i informisanje, stara se o informisanju medija o protokolarnim aktivnostima u Sudu i za Sud.

Glavne dužnosti i odgovornosti:

- Organizuje ceremonije za prijem i ispraćaj i sprovodi sva protokolarna pravila tokom poseta delegacija;
- Sarađuje i usklađuje rad sa drugim protokolarnim službama drugih institucionalnih subjekata za sastanke predsednika Suda i sudije sa predstavnicima raznih državnih i međunarodnih institucija;
- Prati kalendar državnih praznika i, u koordinaciji sa šefom kabineta, savetnikom za međunarodne odnose kao i direktora Kancelarije za komunikaciju i informisanje, stara se o izradi i slanju telegrama i službenih poziva u ime predsednika i u ime sudija Suda za homologne sudove, kao i za druge državne i međunarodne organe;
- Stara se o pripremi i izgledu službenih poklona Suda;
- U koordinaciji sa šefom kabineta, savetnikom za međunarodne odnose kao i direktora Kancelarije za komunikacije i informisanje, priprema i sastavlja listu učesnika na službenim sastancima i očekivanjima predsednika Suda;
- Izrađuje zapisnike sa sastanaka i službenih poseta Sudu;
- Održava arhivu fotografskih materijala, video i audio, sa aktivnosti u Sudu i službenih poseta van zemlje; i
- Obavlja i druge stručne poslove na zahtev direktora Kancelarije za komunikaciju i informisanje, predsednika i sudija.

Minimalne kvalifikacije, radno iskustvo i sposobnosti:

- Visoka stručna sprema u međunarodnim odnosima, pravima, protokolu, komunikacije ili slično; i,
- Najmanje 3 (tri) godine radnog iskustva u domaćim institucijama/organizacijama ili u međunarodnim institucijama vezano za oblast ove pozicije.

Službenik za protokol treba da poseduje odlične organizacione i sposobnosti planiranja i da bude spreman da radi fleksibilno radno vreme; dobro razvijene sposobnosti komunikacije (usmene i pismene); da ima iskustvo upravljanja elektronskom poštom i korišćenje interneta; sposobnost da delotvorno radi pod vremenskim pritiskom; sposobnost prepoznavanja prioriteta i obavljanja nekoliko zadataka u isto vreme, sposobnost da samostalno radi sa minimalnim nadzorom, kao i u timskom okruženju; odlično poznavanje računara, posebno MS Word i Excel programa; poznavanje albanskog, srpskog i engleskog jezika, uključujući i razvijene sposobnost sastavljanja dokumenata.

2.
Pozicija: Službenik za veb stranice i multimedije

Kod: SP- ZKI 06
Broj pozicija: 1 (jedna)
Trajanje imenovanja: Karijerno (neograničeno)
Probni rad: 1 (jedna) godina

Opšti opis pozicije:

Pod nadzorom direktora Kancelarije za komunikaciju i informisanje (KKI), službenik/ca za veb stranice i multimedije prati informativne članke i video zapise na društvenim medijima/mrežama u vezi sa radom Suda, upravlja stranicama Suda na društvenim medijima/mrežama, priprema i objavljuje informativne video zapise na stranicama Suda na društvenim medijima/mrežama, prepoznaje mogućnosti za promovisanje rada Suda na društvenim medijima/mrežama.

Glavne dužnosti i odgovornosti:

- Praćenje informativnih članaka i video zapisa objavljenih na društvenim medijima/mrežama u vezi sa radom i aktivnostima Suda;
- Priprema periodičnih izveštaja u vezi sa pitanjima obrađenim na društvenim medijima/mrežama o radu i aktivnostima Suda;
- Objavlivanje i ažuriranje saopštenja o radu i aktivnostima Ustavnog suda na stranicama Suda na društvenim medijima/mrežama;

- Direktan prenos konferencija za štampu, rasprava, video intervju i drugih informativnih video zapisa na stranicama Suda na društvenim medijima/mrežama, u konsultaciji sa direktorom KKI-a;
- Upravljanje odeljkom za komentare i pitanja na veb stranicama Suda društvenih medija/mreža;
- Priprema i dizajn statističkih tabela i kratkih/dugih informativnih video zapisa vezanih za rad i aktivnosti Suda, te njihova promocija na stranicama Suda na društvenim medijima/mrežama;
- Identifikovanje mogućnosti i izrada predloga za promociju rada i aktivnosti Suda na društvenim medijima/mrežama;
- Obavlja i druge stručne poslove na zahtev direktora Kancelarije za komunikaciju i informisanje;

Minimalne kvalifikacije, radno iskustvo i sposobnosti:

- Univerzitetska diploma iz oblasti komunikacija i novinarstva, društvenih nauka ili drugih relevantnih oblasti;
- Najmanje 4 (četiri) godine profesionalnog radnog iskustva u oblasti komunikacije i praćenja društvenih medija/mreža u institucijama ili međunarodnim organizacijama;
- Odlično poznavanje albanskog i engleskog jezika u govornom i pisanom obliku; poznavanje srpskog i engleskog jezika je prednost;
- Odlično poznavanje rada na računaru, sa programima/aplikacijama za obradu foto i video materijala, u korišćenju interneta i društvenih platformi/mreža.

Kandidat za poziciju službenika za veb stranice i multimedije mora posedovati: dobro razvijene komunikacijske sposobnosti; sposobnost efikasnog rada pod vremenskim pritiskom; odlične organizacione i planske sposobnosti; sposobnost postavljanja prioriteta i obavljanja više zadataka istovremeno; sposobnost samostalnog rada, kao i u timskom okruženju; odlične veštine za korišćenje računara, elektronske pošte, interneta i posebno različitih društvenih platformi/mreža; kao i da ima iskustvo u korišćenju računarskih programa za pripremu foto/video informativnih materijala;

3.
Pozicija: Prevodilac sa albanskog na engleski i srpski i obrnuto
Kod: SP-DPP -06
Broj pozicija: 1 (jedan)
Trajanje imenovanja: Karijerno (neodređeno)
Probni rad: 1 (jedna) godina

Opšti opis pozicije:

Pismeno i simultano prevođenje tekstova, materijala, dopisa, dokumenata i zakona sa albanskog, engleskog i srpskog i obratno, kao i pružanje kvalitetne podrške prevoda, obezbeđujući da je izgled prevedenog dokumenta u potpunom skladu sa originalnim dokumentom, pod nadzorom direktora Departmana za profesionalnu podršku. Simultani prevod sa albanskog, engleskog i srpskog jezika i obrnuto tokom sastanaka i radnih sednica Ustavnog suda.

Glavne dužnosti i odgovornosti:

- Pismeno prevodi materijale i dokumenta Ustavnog suda sa albanskog na engleski i srpski jezik i obrnuto;
- Simultan prevod tokom sastanaka i sednica Suda sa albanskog na engleski i srpski jezik i obrnuto;
- Stara se o strukturi reči i rečenica u prevedenim dokumentima;
- Pomaže i sarađuje sa urednicima/lektorima Suda u određivanju i usklađivanju terminologije prevedenih testova;
- Pomaže i prati sudije na radnim sastancima i deluje kao prevodilac/tumač; i
- Obavlja i druge poslove na zahtev direktora Departmana za profesionalnu podršku.

Minimalne kvalifikacije, radno iskustvo i sposobnosti:

- Viša stručna sprema, poželjno iz filološke i pravne oblasti;
- Najmanje 2 (dve) godine relevantnog stručnog iskustva u prevođenju.

Prevodilac treba da bude energičan, da poseduje dobre međuljudske osobine i da je spreman da radi sa fleksibilnim radnim vremenom. Poznavanje rada na računaru i softverskim aplikacijama, kao što je: MS Word, uključujući naprednu obradu teksta, MS Excel i MS Outlook je obavezna.

Opšte informacije za kandidate

Određivanje plate za objavljeno radno mesto se vrši u skladu sa Poslovníkom o radu i odlukom Ustavnog suda.

Ustavni sud pruža jednake mogućnosti zapošljavanja i očekuje zahteve od pripadnika neveličinskih zajednica i ženskih kandidata. Politika rodne zastupljenosti i svih zajednica na Kosovu će biti sprovedena tokom procedure prijema u Ustavnom sudu Republike Kosovo.

Procedura konkurisanja

Zainteresovani kandidati treba da podnesu odgovarajući zahtev, kome prilažu profesionalnu biografiju, motivaciono pismo, kao i odgovarajuću dokumentaciju o školskoj spremi i potrebnom radnom iskustvu.

Zahtev se može dobiti u štampanoj formi na prijavnici Ustavnog suda i može se preuzeti sa internet stranice Ustavnog suda www.gjk-ks.org.

Zahtev i sva ostala dokumenta mogu se podneti putem elektronske pošte, na sledeću imejl adresu: gjk.burimetnjerezore@gjk-ks.org, putem poštanske službe ili u štampanoj formi u kancelariji Odeljenja za administraciju i ljudskih resursa (OALJR) Ustavnog suda.

Unutrašnja konkurencija ostaje otvorena 15 (petnaest) dana od dana objavljivanja na internet stranici Suda i javnog oglasa, počevši od datuma 16/03/2022 do datuma 30/03/2022. koji se smatra poslednji dan zatvaranja konkurisanja.

Poslednji datum za prijem zahteva je 30/03/2022, do 16.00 časova.

Napomena:

Zahtevi podneti nakon poslednjeg datuma neće biti primljeni. Nekompletni zahtevi mogu biti odbijeni.

NJOFTIM

Njoftojme te gjithë klientet se Kompania EUROPA 2 SH.P.K. me seli ne RAHOVEC, ka marre vendim te shuaj biznesin me numer te regjistrimit :810734724 dhe ka caktuar likuidatorin per zhvillimin e procedures se Likuidimit. Njoftohen te gjithë klientet qe kane raporte Kreditore-Debitore ne kete shoqeri qe te paraqiten ne afatin 30 ditor nga data e shpalljes ne gazete.

OBAVESTENJE

Obaveštavamo sve kupce da je kompanija EUROPA 2 SH.P.K. sa sedištem u RAHOVEC, odlučila da zatvori posao sa registracijskim brojem: 810734724 i imenovala likvidatora za razvoj postupka likvidacije. Obaveštavaju se svi klijenti koji imaju kreditno-debitne izveštaje u ovoj kompaniji da se pojave u roku od 30 dana od dana objavljivanja u novinama.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the company EUROPA 2 SHPK based in RAHOVEC, has decided to close the business with registration number: 810734724 and has appointed the liquidator for the development of the Liquidation procedure. All clients who have Credit-Debit reports in this company are notified to appear within 30 days from the date of publication in the newspaper.

LAJMËROJMË

Bashkëpronarët Shaqir Rasma, Dragoslav Petyroviq dhe Svetislav Petroviq, nga Fshat Mushnikovë Komuna Prizrenit, si Blerësit potencial se, ne Bashkëpronarët Novica Adxhellkoviq, Mlaxhan Fuksanoviq, Illij Mladenoviq, Stanislavka Mitroviq de Zivko Mlladenoviq, si bashkëpronarë ligjor të ngastrave kadastrale me numër P-71611071-02837-1, sipërfaqe të përgjithshme prej 351 m2, në Zonën Kadastrale Mushnikovë, **po i SHESim - pjesët tona bashkëpronësore.** Në këtë mënyrë i ofroj bashkëpronarëve, poqë se janë të interesuar për blerje, të më lajmërohen në afat prej 30 ditëve, në adresë: rr. " Fehmi LLadrovci " nr.70 – Prizren. Një herri informoj se, e kam Blerësin potencial i cili brenda afatit prej 30 ditëve do ta paguan çmimin e përgjithshëm prej 5.000.00 € (Vpeseqind mijë euro) me para të gatshme-në kesh.

Telefoni kontaktues: +383 (0) 44-351-471

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Ajhan Isljami shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Naim Hoxha shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.
- ▶ Besar Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit: **044-514-373 dhe 044-199-707.**

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

